# Tiranë/ Djalit të piktorit Sali Shijaku i gjendet arsenal armësh në banesë, shpallet në kërkim! Në hetim i biri, shkonte me thika në shkollë

*Djali i piktorit Sali Shijaku u shpall në kërkim nga policia pasi u gjet arsenal armësh në banesë dhe shtynte djalin e mitur për përdorimin e tyre. 16-vjecari shkonte në shkollë me thika, ndërsa pas kontrollit të shtëpisë së babait Orges Shijaku u gjetën 6 armë zjarri dhe municione.*

Sokol Demo
27 Shkurt, 09:22 | Përditësimi: 27 Shkurt, 15:47

Share

**TIRANË**- Orges Shijaku mund të jetë artist shumë i njohur dhe biri i një piktori të madh si Sali Shijaku, por kjo nuk e ka penguar që djalit të tij të mitur t'i mësojë dhe këshillojë përdorimin e thikave dhe armëve të zjarrit. Në këto foto shfaqet i mituri, teksa pozon me armë, me gjasa i fotografuar nga i ati.

Por, 16-vjecari merrte thika me vete edhe brenda shkollës. Agjentët e Komisariatit nr. 3 në kryeqytet po e hetojnë në gjendje të lirë, ndërsa babanë e tij e shpallën në kërkim. Fillimisht bluë morën informacion se një grup shokësh në shkollën "Lidhja e Prizrenit" hynin dhe dilnin me thika dhe organizuan një kontrollë të befasishëm në operacionin "Around", nga i cili rezultoi se vetëm djali i Orges Shijakut kishte me vete 2 të tilla.

Policia nuk e la me kaq, ndërsa në kontrollin e shtëpisë së babait të tij, në një dhomë që shërbente si studio dhe ambient për të fjetur, u gjet një arsenal i tërë me armë zjarri. Bëhet fjalë për 6 armë në total, pushkë, shotgun, armë sportive, armë gjysmë automatike, sasi municioni luftarak të kalibrave të ndryshëm, 2 mjete prerëse, si dhe 2 palë targa. I mituri u tha hetuesve se armët ishin të babait, në shtëpinë e të cilit shkonte shpesh pasi vetë jetonte me nënën, për shkak se çifti ishin të divorcuar.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
**Veliaj: E kemi transformuar komplet 'Myslym Shyrin', sot një nga zonat më të lakmuara në Tiranë**

Policia i gjeti 16-vjecarit dhjetëra foto dhe video në celular, me të cilat kishte pozuar me armë zjarri brenda ambientave të shtëpisë, ndërsa kanë dyshime të forta se babai i tij e shtynte në përdorimin e tyre. Orges Shijaku aktualisht gjendet në Zvicër dhe është shpallur në kërkim nga policia për armët e gjetura në shtëpi dhe përfshirjen e të birit për përdorimin e tyre.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Ta Fundit

Ora 10:45

## Iu gjetën 6 armë në banesën në Tiranë, Orges Shijaku, djali i piktorit, Sali Shijaku

Orges Shijaku, të cilit iu gjet arsenal armësh është djali i piktorit të njohur Sali Shijaku, edhe vetë artist, skulptor, restaurator dhe piktor. Agjentët e Komisariatit nr. 3 morën informacion se një grup prej 4 apo 5 nxënësish në shkollën "Lidhja e Prizrenit" në Tiranë lëvizinin me thika brenda shkollës dhe befasisht organizuan kontrollë. Të vetmit që iu gjetën 2 thika ishte djali i mitur i Orges Shijakut.

Më pas, gjatë kontrolleve në shtëpi u gjetën armatimet e tjera, të cilat gjetur në një dhomë që shërbente edhe për fjetje edhe studio arti. Djali i mitur u ka thënë hetuesve se armët janë të babait dhe në celular i janë gjetur dhjetëra foto të cilat ishin shkrepur brenda shtëpisë, po me armë. Djali jetonte me nënën, pasi Orges Shijaku ishte divorcuar nga bashkëshortja, por shkonte shpesh në shtëpinë e babait. Shijaku për momentin rezulton jashtë kufijve të vendit, në Zvicër.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Si E.r/k./Shqiptarja.com

TAG: arsenal armesh | Orges Shijaku | Tirane | Sali Shijaku

Komentoj

Komente

Abc: 27/02/2024 14:34
Mire qe qe s'jaaskan vrare ndonje turist se shtepia e Sali Shjakut eshte ne cdo guide turistike te Tiranes. Turp tu vije qe i nxijne fagen gjyshit qe ka qene piktor i mirenjohur.
Përgjigju

Erdi: 27/02/2024 14:29
O miiet a keni tru apo jo???? ..kshu ka ardh koha...kur arrin djali i nje artisti me u marr me kete pune mendoni ku jemi
Përgjigju

E vertetа: 27/02/2024 14:19
Turp per babain nese e ka bere nje gje te tille. Me sa duket nuk e dashka te birin se shpjegojn tjeter ska. Ne ankohemi per zonat rurale.
Përgjigju

Pelion: 27/02/2024 13:59
Kështu është kur rodit i hyn vetja në qef e fryhet me koqet e babait, jo më kot populli thotë nga ferra lind trëndafili e nga trëndafili lind ferra respekt për të madhin Sali Shijaku.
Përgjigju

The trailors: 27/02/2024 10:37
Kafshe mesatare
Përgjigju

O Zot: 27/02/2024 10:01
Hajde baballar hajde, e pastaj kan faj femijet.Jo mor jo, sthote kot populli, cte mbjellesh do korresh.
Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SONDAZH

**Sondazhi i ditës:**
**A e forcon rolin e Shqipërisë zhvillimi në Tiranë i samitit për Ukrainën?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Samiti për Ukrainën e liderët e Ballkanit sot dhe nesër, ja rrugët që të cilat ndalohet qarkullimi
28 Shkurt, 07:23

FOTO/ Gjendet një motor i braktisur në lumin e Lanës në Tiranë
27 Shkurt, 17:06

Nga Shkodra drejt Rinasit për të shitur armë, arrestohet 45-vjecari, u gjet edhe kokainë e kanabis (EMRI)
27 Shkurt, 10:30

Nga Mariana Kondi, Bojken Lako dhe tre baleriniët, personazhet e njohur i bashkohen nismës së bashkisë për mbjelljen e pemëve në Tiranë (FOTO)
27 Shkurt, 10:16

Zelensky mbërrin në Tiranë, pritet nga ministrat Hasani e Spiropali! Shoqëronhet nga eskorta me rreth 35 mjete e automjete
27 Shkurt, 08:31

Zjarr në kabinën elektrike të një pallati në Tiranë
26 Shkurt, 21:05

Preç Zogaj: 'Shpërblimi' i Tiranës zyrtare për stabilitetin në rajon është kompromentuar nga korrupsioni masiv

Preç Zogaj
26 Shkurt, 20:20

Nga bursat për rxënësit tek ndihma ekonomike, Këshilli Bashkiak miraton disa vendime të rëndësishme
26 Shkurt, 16:57

Tirana mirëpret samitin për Ukrainën dhe liderët e Ballkanit: Ja rrugët që do të bllokohen më 28 - 29 shkurt
26 Shkurt, 14:09

EMRI/ Vidhte portofola e celularë, arrestohet 41-vjecari në Tiranë (VIDEO)
26 Shkurt, 09:54

Veliaj në Njësinë 13: Lagje ku është ritur ndjeshëm vlera e pronës! Edhe kundërshtarët politikë jetojnë në mirë nën drejtimin e PS
25 Shkurt, 18:42

Grafë preferojnë të lindin në Tiranë, braktisin maternitetin e Fierit! Drejtoresha e spitalit: Mungon infrastruktura

Kristaq Thano
25 Shkurt, 18:07